



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR PËR AUDITIMIN TEMATIK TË USHTRUAR
NË
“RADIO TELEVISIONIN SHQIPTAR”

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËRPUTHSHMËRIE
NË “RADIO TELEVISIONIN SHQIPTAR”

**(Me tematik: “Organizimi i Festivalit të 62 Kombëtar
i Këngës në RTSH”)**

TIRANË, Korrik 2024

PËRMBAJTJE

Nr.		
I.	PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	3
1	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.	3
2	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	3
3	Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit	8
II.	HYRJA	9
1	Objektivat dhe Qëllimi i auditimit.	9
2	Identifikimi çështjes	9
3	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	9
4	Përgjegjësitë e audituesve	9
5	Kriteret e vlerësimit	10
6	Standardet e auditimit	10
7	Metodat e auditimit	10
8	Dokumentimi i auditimit	11
III.	PËRSHKRIMI I AUDITIMIT	11
1	1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	11
2	2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	11
IV.	GJETJET DHE REKOMANDIMET	30
1	Masa Organizative	30
2	Masa shpërblim dëmi	31
	Masa për Eliminimin e Efekteve Negative të Konstatuara në Administrimin e	
3	Fondeve Publike dhe për Menaxhimin me Ekonomicitet, Eficence dhe Efektivitet të Fondeve Publike	32
V.	ANEKSE	34

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1. Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit.

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të Autorizimit nr. 564/47 Prot., datë 16.02.2024, i ndryshuar dhe në vijim të programit të auditimit nr. 564/1, datë 26.07.2023, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, u zhvillua auditimi me tematikë “Organizimi i Festivalit të 62 Kombëtar i Këngës në RTSH”, pranë Radio Televizionit Shqiptar (RTSH).

I.2. Përshkrim i përmbledhur i gjetjeve dhe rekomandimeve nga auditimi

Nga auditimi u konstatua se me urdhrin nr. 96, datë 13.07.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH, është ngritur grupi i punës për Festivalin e 62 të Këngës në RTSH, në përbërje të të cilit nuk ka asnjë person specialist të fushës për të garantuar hartimin e kërkesave teknike për zhvillimin e festivalit. Urdhri nuk përcakton detyra konkrete për grupin e punës, pra në urdhër nuk përcaktohet se nga kush do të kryhet hartimi i kërkesave teknike të skenografisë për zhvillimin e festivalit.

Nga auditimit i Rregullores së Festivalit të 62 të Këngës për vitin 2023, si dhe Platformës Regjisoriale dhe Artistike hartuar nga regjisori i festivalit z. P. K dhe drejtori artistik i festivalit, z. B. L, hartimi i kërkesave teknike, pjesë e platformës regjisoriale, nuk janë në kompetencat e drejtorit artistik dhe të regjisorit të festivalit.

Nga intervistimi me anëtarët grupit të punës, shqyrtimi dhe vlerësimi i hartimit të kërkesave teknike, u konstatua se përgatitja e skenografisë nuk është kryer nga grupi i punës. Anëtarët e grupit të punës, për çështjet teknike të skenografisë, në kushtet kur nuk janë të hartuar nga ana e tyre, nuk duhet të kishin pranuar dhe miratuar një dokument i cili është hartuar nga persona apo subjekte të cilët nuk kanë marrëdhënie kontraktuale me RTSH.

Gjithashtu Rregullorja e Festivalit të 62 të Këngës nuk është hartuar e plotë, pasi ka mangësi në përcaktimin e detyrave konkrete për punonjësit, konkretisht nuk është parashikuar se cilët janë personat përgjegjës të cilët. Si rekomandim u la që titullari i institucionit, në zhvillimet e projekteve artistike, veçanërisht projektit artistik Festivali i Këngës, ku vlera dhe rëndësia e zhvillimit është e lartë, të përfshijë në grupet e punës ekspertë të hartimit të kërkesave teknike dhe të skenografisë, si dhe gjatë hartimit të rregullores për festivalet e këngës, të përcaktojnë në këtë dokument rolin dhe detyrat e anëtarëve të grupit artistik, me qëllim që të jetë e qartë se çfarë detyrash do të kryej secili anëtar i grupit të punës.

Nga auditimi i preventivit financiar të shpenzimeve për zhvillimin e Festivalit të 62 të Këngës, grupi i auditimit konstatoi se nuk ka transparencë se cila ishte rruga e ndjekur nga institucioni për marrjen e ofertave nga OE në treg. Grupit të auditimit nuk ju vu në dispozicion dokumentacion mbi korrespondencën me OE, por vetëm ofertat e dërguara nga disa prej tyre. Nuk është e qartë se si u informuan OE për të paraqitur oferta pranë RTSH-së.

Edhe pse procesi i marrjes së ofertave, analizës së tyre (për shkak të numrit të madh të elementëve përbërës të zërave përkatës), kërkon kohën e nevojshme, ashtu sic e kërkon këtë kohë dhe hartimi i preventivit të projektit artistik, konstatohet se i gjithë ky proces është bërë brenda së njëjtës datë, pra ofertat janë të protokolluara në të njëjtën datë me dërgimin e shkresës për miratimin e preventivit pranë Bordit të Administrimit, datë 06.12.2023.

Gjithashtu preventivi final nuk është i detajuar dhe nuk shpjegohet se si u arrit të përcaktohen vlerat përkatëse, mbi zëra e projektit për të cilët mungojnë të dhënat kryesore që përcaktojnë vlerën

e tyre. Si rekomandim u la që nga titullari i institucionit, personat përgjegjës mbi zhvillimin e projekteve artistike, për përcaktimin e fondit, të kryet një procedurë transparente dhe gjithëpërfshirëse në lidhje me përcaktimin e fondeve të projekteve artistike, marrjen e ofertave në treg, adresimin e saktë që përkojnë me objektin dhe veprimtarinë e OE.

Për akomodimin e të ftuarve të Festivalit, Radio Televizioni Shqiptar ka lidhur marrëveshje me K. H & T me nr. 2299/15 Prot., datë 15.12.2023. Nga auditimi u konstatua që për pjesëmarrës të caktuar kohëzgjatja e qëndrimit në hotel është më e madhe se 4 netë (netë që përkojnë me zhvillimin e festivalit). Personat e përfshirë në preventivin e pagesave për akomodimin në hotel, janë punonjës të cilat kanë punuar për skenografinë e festivalit, të punësuar pranë kompanisë D. P. AL (kompania që ka realizuar Skenografinë).

Në kushtet e kontratës të lidhur midis RTSH dhe OE D. P. AL, nuk është përfshirë zëri për akomodimin e punonjësve të kompanisë në hotel dhe për këtë arsye shpenzimet për këtë zë, nuk duhej të ishin kryer nga fondet e RTSH. Vlera e shpenzuar për akomodimin e punonjësve prej **248,044 lekë pa TVSH**, përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit. Si rekomandim u la që Titullari i institucionit, të marrë të gjitha masat e duhura ligjore, për kthimin e vlerës prej **248,044 lekë pa TVSH** nga OE D. P. AL, si vlerë e përfituar jashtë marrëdhënieve kontraktuale, si dhe të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për këtë parregullsi.

Nga auditimi u konstatua se në preventivin e projektit për zhvillimin e festivali janë përfshirë mallra si zëra më vete, ndërkohë që janë elementë përbërës të shërbimit, duke krijuar mbivendosje në preventiv. Konkretisht zërat e mëposhtëm:

Kavallota, copë 200 me vlerë 213,339 lekë pa TVSH, tuba fi 48, ml100 me vlerë 58,919 lekë pa TVSH, janë materiale përbërës të cilët shërbejnë për realizimin e skenografisë, pra janë pjesë e shërbimit i cili është paguar njëherë nga RTSH dhe në këtë mënyrë, nuk mund të përfshihen si të ndarë në preventivin e projektit artistik si mall më vete. Për sa më sipër vlera prej 272,258 lekë pa TVSH konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e shtetit. Si rekomandim u la që Titullari i institucionit, të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për kthimin e vlerës prej **272,258 lekë** pa tvsh nga OE D. P. AL, si dhe të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për këtë parregullsi.

Sipas kontratës nr. 2800/2 Prot., datë 13.12.2023 të lidhur midis Radio Televizioni Shqiptar dhe "A.S.V.L"sh.p.k. me NIPT L.....M, neni 2, pika 1, citohet që janë të integruara së bashku me elementët përbërës ndihmës, që do të thotë që zërat e përfshira në zërin Skenografia në preventivin në lidhje me bazamentet për Ledwall dhe Ledfloor, Plex për Ledfloor (të cilat janë të përfshira në Ledwall display floor dhe Led display), si dhe zëri Led Strip RGB (i përfshirë në zërin Ndrëhim set up salla), në vlerën respektive 1,836,549 lekë dhe 645,263 lekë sipas kontratës të lidhur midis RTSH-së dhe O.E. D. P. AL me nr. 2800/3 Prot., të jenë të preventuar në mënyrë fiktive. Efekti financiar në total në vlerën prej 2,481,812 lekë pa tvsh përbën dëm ekonomik mbi Buxhetin e Shtetit. Si rekomandim u la që Titullari i institucionit, të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për kthimin e vlerës prej 2,481,812 lekë pa tvsh nga O.E. D. P. AL si dhe të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për këtë parregullsi.

Në parashikimin e buxhetit për vitin 2023 për projektin artistik Festivali i Këngës vlera është 47,000,000 lekë, ndërkohë që vlera e miratuar nga Këshilli Drejtues është 60,000,000 lekë. Si argumentim mbi rritjen e fondit prej 13,000,000 lekë, Këshilli Drejtues jep normën e inflacionit. Nga të dhënat zyrtare të Bankës së Shqipërisë norma e inflacionit, për vitin 2023 mesatarisht është 4.8%, që për vlerën e mësipërme të buxhetit prej 47,000,000 lekë, fondi për realizimin e projektit artistik Festivali i Këngës, duhej të ishte në vlerën 49,256,000 lekë (2,256,000 lekë shtesë inflacioni). Diferenca prej 10,744,000 lekë (13,000,000-2,256,000), e cila është rritje e paargumentuar e vlerës së projektit artistik, konsiderohet si fond i përdorur pa ekonomikitet,

eficencë dhe efektivitet. Si rekomandim u la që Titullari i institucionit, Bordi i Administrimit, Këshilli Drejtues, të ndërpresë praktikën e hartimit dhe miratimit të projekteve artistike me vlera financiare të paargumentuara, me qëllim përdorimin e fondeve publike me efikasitet, ekonomikitet, efikasitet dhe të mos çënimin të burimeve financiare nga zërat e tjerë të planifikuar në buxhetin e institucionit.

I.3 Konkluzioni i përgjithshëm i auditimit

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së Radio Televizionit Shqiptar, RTSH, me fokus “Organizimin e Festivalit të 62 Kombëtar i Këngës në RTSH”. Nga auditimi i ushtruar u konstatua se Rregullorja e miratimit dhe e zbatimit të projekteve artistike dhe filmike e miratuar me datë 26.03.2018 me Vendim nr.10, nuk parashikon mënyrën se si do të ndërtohen projektet artistike, veçanërisht për Festivalin Kombëtar të Këngës së RTSH-së, hartimin e projekteve, përcaktimin e kostove, përzgjedhjen e Operatorëve për realizimin e projekteve dhe menaxhimin e burimeve njerëzore për finalizimin e tij.

Në të gjithë hierarkinë e veprimeve të realizimit të Festivalit të Këngës, nuk ka transparencë të plotë dhe gjurmë dokumentare, si në hartimin e projektit, përcaktimin e burimeve njerëzore (përfshirë jurinë, të ftuarit, stafi artistik dhe administrative, stafi realizues), përcaktimin e kostove dhe tarifave përkatëse, caktimin e operatorëve pjesëmarrës për realizimin e tyre me kostot përkatëse (përfshirë dhe akomodimin).

Hartimi i specifikimeve teknike, përgatitja e skenografisë është kryer nga individë të cilët nuk ishin pjesë e grupit të punës, jo në marrëdhënie pune me Radio Televizionin Shqiptar si dhe nuk ka një marrëveshje ose një kontratë midis palëve.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të Autorizimit nr. 564/47 Prot., datë 16.02.2024, i ndryshuar dhe në vijim të programit të auditimit nr. 564/1, datë 26.07.2023, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i Kontrollit të Lartë të Shtetit, u zhvillua auditimi me tematikë “Organizimi i Festivalit të 62 Kombëtar i Këngës në RTSH”, pranë Radio Televizionit Shqiptar (RTSH), me përbërje:

1. V. B.
2. E. K.

1. Objektivat dhe qëllimi

Në objektivat dhe qëllimet e auditimit përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara për periudhën objekt auditimi përputhen me kriteret përkatëse të kuadrit rregullator. Objektivi i Auditimit është dhënia e opinionit nëse Radio Televizioni Shqiptar, në të gjithë aspektet materiale, aktiviteti ekonomik dhe financiar, transaksionet dhe informacioni janë në përputhje ose jo me dispozitat ligjore dhe rregulloret përkatëse.

Qëllimi i këtij auditimi përputhshmërie është evidentimi i devijimit nga standardet e pranuar i shkeljes së parimeve të ligjshmërisë, të menaxhimit financiar me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korigjuese nga ana e subjektit të audituar.

Me auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e proceseve dhe aktiviteteve të institucionit.

2. Identifikimi i çështjes

Projekt Raporti mbi auditimin e përputhshmërisë të Radio Televizionit Shqiptar për “Organizimi i Festivalit të 62 Kombëtar i Këngës në RTSH”, në kontekstin e vlerësimit të aktiviteteve që kanë të bëjnë me administrimin e fondeve buxhetore, hierarkinë dhe transparencën e vendimmarrjeve të organeve drejtuese.

3. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës.

Strukturat drejtuese janë përgjegjëse për realizimin e objektivave dhe zbatimin e përgjegjësive të caktuara në kuadrin ligjor dhe rregullator, për të menaxhuar fondet publike në mënyrë të ligjshme, me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.

4. Përgjegjësitë e audituesve

Audituesit e KLSH-së janë përgjegjës për dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuar si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kritereve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj.; shpreh nëpërmjet opinionit të auditimit, duke respektuar Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI, si dhe kodin e etikës me qëllim që të arrihet niveli i arsyeshëm i sigurisë për dhënien e opinionit, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

5. Kriteret e vlerësimit

Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA)IFAC; (ISSAI) të INTOSAI-t;

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Baza Ligjore:

Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

Ligji nr. 97, datë 4.03.2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”;

Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar;

Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për Sponsorizimet”, i ndryshuar;

Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;

Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”;

Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;

Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar;

Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

6. Standardet e auditimit

Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranura të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Projekt Raporti i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, mbështetur në:

- Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
 - Kodi etik i KLSH dhe Rregullorja e Brendshme;
 - ISSAI 100- Parimet themelore të auditimit të sektorit publik;
 - ISSAI 400-Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë;
 - ISSAI 4000-Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”;
 - ISSAI 1500 (ISA 500)- Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij;
 - Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;
 - Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI “Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë”;
- si dhe në praktikat më të mira të fushës.

7. Metodatat e auditimit

Audituesit e KLSH-së, mbi bazën e evidencave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion, intervistave, takimeve dhe konsultave me nëpunësit e Radio Televizionit Shqiptar, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kriterëve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit, të gjykimeve, të përfundimeve të arritura, programin e auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, të finalizuar me akt konstatimet, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Projekt Raporti.

8. Dokumentimi i auditimit

Është kryer bazuar në kërkesat e manualit të auditimit financiar dhe të përputhshmërisë, në standardet ndërkombëtare të auditimit (ISAI), për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore dhe rregullatorë.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Radio Televizioni Shqiptar (shkurt RTSH; më herët si TVSH) është një institucion mediatik publik që përfshin Radio Tiranën, që u krijua në vitin 1938 dhe Televizionin Shqiptar, që u krijua në vitin 1960.

RTSH kryen shërbimet e transmetimit publik në fushën e shërbimeve audio dhe audiovizive në Republikën e Shqipërisë, i cili vepron në bazë të Ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”. Gjithashtu, në Statutin e saj, të miratuar me vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 98/2016 “Për miratimin e statutit të Radio Televizionit Shqiptar (RTSH)”, përcaktohen rregullat për funksionimit e RTSH-së.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit.

Në zbatim të Autorizimit nr. 564/47 Prot., datë 16.02.2024 me objekt zhvillimin e auditimit tematik “Organizimi i Festivalit të 62 Kombëtar i Këngës në RTSH”, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Buxheti i miratuar për vitin 2023 me ndryshimet përkatëse
- Regjistri i Aktiveve (për verifikimin e zërave të përfshirë në organizimin e festivalit)
- Dosja (Praktika) që përmban dokumentacionin e plotë justifikues mbi zhvillimin e Festivalit të 62 Kombëtar të Këngës në RTSH (nga Urdhri për ngritjen e grupit të punës deri në miratimin e fondit nga Këshilli Drejtues)
- Kontratat e lidhura me palët e përfshira në këtë proces (Shërbimet, Stafi, Artistët, Kompozitorët, Poetët, Orkestruesit), etj.

Projekti Artistik me temë “Organizimi i Festivalit të 62 Kombëtar i Këngës në RTSH”, nis që me përgatitjen e buxhetit për vitin 2023, duke qenë se zhvillimi i projektit artistik është i përvitshëm nga ana e Radio Televizionit Shqiptar. Projekti artistik i mësipërm cilësohet në Buxhetin e vitit 2023 si Festivali i Këngës dhe parashikimi i fondit për realizimin e tij është në vlerën 47,000,000 lekë.

Buxheti është miratuar nga ish Drejtori i Përgjithshëm z. E. J. dhe Këshilli Drejtues me përbërje:

- z. G. P. zv/Kryetar dhe anëtarët:
- z. G. P.
- z. I. K.
- z. M. Sh.
- znj. M. S.
- znj. A. R.
- z. E. N.
- z. E. T.
- z. D. ,

Më pas me anë të shkresës nr. 413 Prot., datë 07.02.2023, ish Drejtori i Përgjithshëm z. E. J. i drejtohet Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare, Drejtorisë së Pallatit të Kongreseve Tiranë, mbi rezervimin e ambienteve të Pallatit të Kongreseve për zhvillimin e projektit artistik.

Me anë të kërkesës nr. 1424 Prot., datë 12.07.2023 Drejtori i Kabinetit të RTSH-së i drejtohet ish Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH, z. A. P., për nevojën e ngritjes së grupit të punës për Festivalin e 62 të Këngës në RTSH. Me urdhrin nr. 96, datë 13.07.2023 nga Drejtori i Përgjithshëm i RTSH, ngrihet grupi i punës me përbërje si më poshtë:

- | | |
|-------------|------------------------------|
| z. B. L. | - Drejtor Artistik |
| z. P. K. | - Regjisor |
| z. E. D. | - Skenarist |
| znj. I. L. | - Drejtor Organizativ |
| z. Sh. S. | - Producent Muzikor |
| z. A. K. | - Producent Muzikor |
| z. E. Zh. | - Producent Muzikor |
| z. E. D. | - Drejtues i Bandës Muzikore |
| z. K. Q. | - Redaktor Muzike |
| z. E. Sh. | - Redaktor Muzike |
| znj. B. Xh. | - Drejtor Programacioni |
| znj. E. Sh. | - Organizatore |

Urdhri i mësipërm bazohet në ligjin nr. 97/201 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë si dhe Vendimin nr. 98/2016 “Për miratimin e Statutit të Radio Televizionit Shqiptar RTSH. Urdhri i mësipërm nuk përcakton se ku do të bazohet roli, detyrat dhe kompetencat e grupit të punës.

Me anë të shkresës nr. 413/10 datë 17.10.2023 të grupit të punës, drejtuar ish Drejtorit të Përgjithshëm, dërgohet Platforma Regjisoriale dhe Artistike nga Regjisori i Festivalit z. P. K. dhe Drejtori Artistik i Festivalit z. B. L. Edhe në këtë rast nuk përcaktohet baza ligjore ose rregullatore se ku është mbështetur hartimi i shkresës së mësipërme si dhe të rolit dhe detyrave që duhen të kenë grupi i punës.

Në përmbajtje të shkresës janë vendosur specifikime të festivalit, që nga prezantuesit, anëtarët e jurisë, organet e festivalit, numri i këngëve në konkurrim, datat e zhvillimit të festivalit përkatësisht 19, 20, 21 dhe 22 dhjetor 2023. Gjithashtu në përmbajtje të shkresës janë vendosur dhe kërkesat teknike si më poshtë:

KËRKESAT TEKNIKE

Për realizimin e Festivalit të këngës të 62-të në RTSH është i nevojshëm suporti teknik i mëposhtëm:

Lista e kamerave, objektiv, stativ.

- Total i kamerave 15
- 12 kamera fikse broadcast të gjitha me sensor 2/3
- 3 kamera lëvizëse në skenë (cimbale) me 3 transmetues wireless.

Objektivat që kërkohen janë: 3 teleobjektivë për baterinë kryesore të kamerave (55x 2 copë dhe 77 x1 copë.

- Kamerat e tjera duhet të jenë me objektiv 16 dhe 20

3 cam me teleobjektiv

- (Dy në qendër bateri dhe një në anësor)
- 3 stativ përkatës

5 cam me objektiv këndgjerë 4,3-4,5

- A-Kran I
- B- Kran 2
- C-Karrele
- D-Kamera mbi skenë. Në tavan me kokë krani dhe xhoistik në pult.
- E-Steady Cam

3 cam në skenë (objektiv normal)

- 3 stativ përkatës
- A – Dirigjent
- B- Harqe
- C – Backvokal, Band

1 cam PP (vendosur në qendër. Bateri, objektiv normal)

1 stativ përkatës, e vendosur në bateri, në qendër

KËRKESA TEKNIKE TË NDRIÇIMIT

Nr	Përshkrimi	Sasia
	Ndriçim set up	
1	Prolights Panorama Eash	30
2	Prolights Panorama AirBeam	30
3	Prolights Panorama IP Spot	30
4	Claypaky K 10	16
5	Prolights Star 400	26
6	Prolights Jade	36
7	Prolights Profile me Led 25-50	26
8	Prolights Lumipar	100
9	Prolights Lumipix led	100
10	Elan 1000 ë RGBV Strobe	40
11	Folloë Spot 600E	4
12	Mixer Grand MA 2	1
13	Mixer Avolittes Sapphari	1
14	Mixer Studio 24	1
15	Makina tymi	6
16	Truss Black ml	100
17	Truss Alumin ml	80
18	Motorra Elektrik	36
19	Intercom ëireless (9 spote)	1

KËRKESA TEKNIKE PËR LEDËALL

Nr	Përshkrimi	Sasia
	Ledëall	
1	Led Display Floor 60 m2	1
2	Led Display 120 m2	1

KËRKESA TEKNIKE TË PAJISJEVE AUDIO

Nr	Përshkrimi	Sasia
	Audio Set up	
1	Outline GTO C12	12
2	Outline Frame GTO	2
3	Outline Mantas 28	18
4	Outline Frame Mantas	3
5	Outline dbs 18-2 (subëoofer)	12
6	Outline Amplifler X Dante Otto	6
7	Outline Amplifler X Dante Quatro	12
8	CM Motors Electric	5
9	Controller Motors	1
10	Mixer Digico 3D 12	1
11	Rack Digico	1
12	Audiotechnica ATM 350	24
13	Shure 98 HC	8
14	Microphone Kick Senn E901	1
15	Microphone Kick Audix D6	1
16	Microphone Kick Beta 52	1
17	Microphone 8M 57	10
18	Microphone Drums Senn E 906	4
19	Microphone Over AT 2050	4
20	Microphone Over KM 184	4
21	Microphone Over Senn 8050	4
22	Microphone Over TLM 103	2

23	Microphone Perkusion ATM 230	4
24	Microphone Beta 58	3
25	Microphone AE 6100	3
26	Lexhio	35
27	Drita Lexhio	40
28	Stand Gravity long	16
29	Stand Gravity short	6
30	Ëirless Mixc Audiotechnica	8
31	Headset	4
32	Ëorless Line GTR	4
33	Distributor Antena	2
34	Rack in Ear Audiotechnica Seria 3000 Transmitter	6
35	Rack in Ear Audiotechnica Seria 3000 Reciver	12
36	Amplifler Headphones	8
37	Ëirless in ear strings Transmitter	4
38	Ëirless in ear strings Reciver	30
39	Distro audio 128 amp	1
40	Kabell audio të ndryshëm	100
41	Kabell audio korenti te ndryshem	40

KËRKESA TEKNIKE PËR NDËRTIMIN E SKENOGRAFISË

Emërtimi	Sasia	Njësia
Struktura layher skena (rental)	320	m2
Bazament për Led ëall (rental)-250 m2: Layher 250 m2, Strukturë metalike 1500 kg, Binare 400 m2	250	m2
Bazament për Led Floor (rental) 60m2, Binare 350 m/lineareL Mdf 19mm 120 m2.Plexiglass transparent 10mm 60m2	60	m2
Planshet skena(Rental) 278 m2, Binare 1150 m lineare, Mdf 8mm 378 m2, Mdf lluster e zeze 400m2, Plexiglass per led dinamik 10m2. Led dinamik 80 m lineare, Polikarbonat 6mx 1.8m+veshje me adeziv te zi	378	m2
2 pedana per kran 8m x6m, Struktore druri me binare dhe veshje me panele druri+tapet(veshje me tapet e pjeses se publikut) ,ndarese ceremoniale 20 cope		
Kembe niveluese rental	20	copë
Plex per ledfloor 10mm	60	m2
Pedanat e muzikanteve	70	m2
Pedanat per dritat 60x60x20	8	copë
Led strip RGB	120	ml
Perde e zeze	50	m2
Tapet i zi	90	m2
Tapet i kuq	120	m2
Tuba fi 48	100	m linear
Kavallota	200	copë
Strukture metalike me baner mat per backstage dhe hollin	98	m2
Krijim dhe konceptim i struktures 3D studio dhe ndjekje punimesh	1	total
Sherbim fotografie dhe ndricimi	1	total
Cope e zeze	300	m2
Dinamik led per muzikantet	120	m linear

Me anë të Vendimit nr. 33, datë 13.12.2023, miratohet Rregullorja e Festivalit të 62 të Këngës për vitin 2023 nga Këshilli Drejtues, protokolluar me shkresën nr. 142/2 Prot., datë 13.12.2023. Në këtë rregullore janë të përcaktuara roli dhe detyrat e organeve kryesore të festivalit.

Detyrat e përcaktuara në Rregulloren e sipërcituar, mbi drejtorin artistik të festivalit, ku në këtë rast përfaqësohet nga z. B. L., janë si më poshtë:

Drejtori artistik i festivalit është përgjegjës për:

- a) drejtimi artistik i festivalit
- b) vlerësimin, përcaktimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e zgjidhjeve artistike të Festivalit
- c) zgjedhjen e artisteve interpretues dhe/ose ekzekutues, në cilësinë e aktorëve, muzikantëve, këngëtarëve, instrumentistëve, valltarëve, të cilët aktrojnë, këndojnë, recitojnë, luajnë, interpretojnë dhe/ose ekzekutojnë në cilësinë e artistit interpretues dhe/ose ekzekutues të ftuar në Festival
- ç) përcaktimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e çdo performance, interpretimi dhe/ose ekzekutimin në Festival
- d) përcaktimin, kontrollin dhe mbikëqyrjen e aktorëve, këngëtarëve, muzikantëve, instrumentistëve, valltarëve et...
- dh) mbikëqyrjen e elementëve teknikë artistikë dhe të elementëve të prodhimit të performancës së artistit interpretues në cilësinë e këngëtarit, i cili këndon këngën pjesëmarrëse ose jo konkurrues të Festivalit
- e) propozon te Drejtori i Festivalit anëtarët e komisionit
- ë) raporton rregullisht te Drejtori i Festivalit
- f) çdo detyrë tjetër të përcaktuar në këtë rregullore

Detyrat e përcaktuara në Rregulloren e sipërcituar, mbi regjisorin e festivalit, ku në këtë rast përfaqësohet nga z. P. K., janë si më poshtë:

Regjisorin është përgjegjës për:

- a) drejtimin e përgjithshëm audioviziv artistik të Festivalit përmes kryerjes së regjisë televizive të Festivalit
- b) kryerjen e kontrollit, të koordinimit, të drejtimit të regjistrimeve audio dhe regjistrimeve audiovizuale të Festivalit, të përzgjedhjes së regjistrimeve audio dhe regjistrimeve audiovizuale të Festivalit, të përzgjedhjes

Për sa më sipër, grupi i auditimit konstatoi që bazuar në Rregulloren e Festivalit të 62 të Këngës për vitin 2023, dhe në shkresën nr. 413/10 datë 17.10.2023 mbi Platformën Regjisoriale dhe Artistike hartuar nga regjisorin e festivalit z. P. K. dhe drejtorin artistik të Festivalit z. B. L., hartimi i kërkesave teknike, pjesë e platformës regjisoriale, nuk janë në kompetencat e drejtorit artistik dhe të regjisorit të festivalit.

Nga auditimi u konstatua se me urdhrin nr. 96, datë 13.07.2023 të ish Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH, është ngritur grupi i punës për Festivalin e 62 të Këngës në RTSH, në përbërje të të cilit nuk ka asnjë person specialist të fushës për të garantuar hartimin e kërkesave teknike për zhvillimin e festivalit. Urdhri nuk përcakton detyra konkrete për grupin e punës, pra në urdhër nuk përcaktohet se nga kush do të kryhet hartimi i kërkesave teknike të skenografisë për zhvillimin e festivalit.

Nga auditimi i Rregullosës së Festivalit të 62 të Këngës për vitin 2023, si dhe Platformës Regjisoriale dhe Artistike hartuar nga regjisorin e festivalit z. P. K. dhe drejtorin artistik të festivalit,

z. B. L., hartimi i kërkesave teknike, pjesë e platformës regjisoriale, nuk janë në kompetencat e drejtorit artistik dhe të regjisorit të festivalit.

Nga intervistimi me anëtarët grupit të punës, shqyrtimi dhe vlerësimi i hartimit të kërkesave teknike, u konstatua se përgatitja e skenografisë nuk është kryer nga grupi i punës. Anëtarët e grupit të punës, për çështjet teknike të skenografisë, në kushtet kur nuk janë të hartuar nga ana e tyre, nuk duhet të kishin pranuar dhe miratuar një dokument i cili është hartuar nga persona apo subjekte të cilët nuk kanë marrëdhënie kontraktuale me RTSH.

Gjithashtu Rregullorja e Festivalit të 62 të Këngës nuk është hartuar e plotë, pasi ka mangësi në përcaktimin e detyrave konkrete për punonjësit, konkretisht nuk është parashikuar se cilët janë personat përgjegjës të cilët kanë për detyrë hartimin e kërkesave teknike, pjesë e platformës regjisoriale. Sa më sipër në mospërputhje me Nenin 4 dhe 8 i Rregullores së Festivalit 62 të Këngës në RTSH.

Në lidhje me sa sipër, është dërguar observacion nga përfaqësues të Radio Televizionit Shqiptar, protokolluar në institucion me nr. 564/53, datë 12.06.2024 në të cilin në mënyrë të përmbledhur thuhet:

Pretendimi i subjektit (i përmbledhur): Në përmbajtje të shkresës janë vendosur specifikime të festivalit, që nga prezantuesit, anëtarët e jurisë, organet e festivalit, numri i këngëve në konkurrim, datat e zhvillimit të festivalit përkatësisht 19, 20, 21 dhe 22 dhjetor 2023. Gjithashtu në përmbajtje të shkresës janë vendosur dhe kërkesat teknike si më poshtë:

- Kërkesat teknike;
- Kërkesa teknike të ndricimit;
- Kërkesa teknike për ledwall;
- Kërkesa teknike të pajisjeve audio;
- Kërkesa teknike për ndërtimin e skenografisë.

Siç e kemi shpjeguar edhe në observacionet ndaj Aktit të Konstatimit nr. 1, ky përfundim nuk qëndron, pasi puna që ka bërë grupi i punës, sipas kërkesave regjisoriale dhe atyre artistike, duke arritur edhe në përfundimin e kërkesave teknike, ka qenë një punë ndihmëse, e cila, në fund, ka sjellë një rezultat konkret dhe kërkesa konkrete dhe lehtësisht të matshme.






Të gjitha këto kërkesa janë justifikuar edhe në formë shkresore në vijim dhe, cka është më e rëndësishme, përmbushja e tyre ka mundësuar organizimin dhe realizimin e Festivalit.

Korrespondencat me kërkesat përkatëse mbi platformën regjisoriale dhe atë artistike janë vënë në dispozicion të Grupit të Auditimit si pjesë e dosjes.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Pas analizimit të observacionit, të dërguar nga përfaqësues të institucionit, grupi i auditimit rithekson dhe njëherë që gjetja konsiston në rolin dhe detyrat e grupit të punës, si dhe në rolin e tyre gjatë hartimit të skenografisë.

Për sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

Në dokumentacionin vijues, vënë në dispozicion grupit të auditimit, gjendet shkresa me nr.2299 Prot., datë 25.10.2023 drejtuar Drejtorit të Përgjithshëm, nga ana e Drejtorit të Drejtorisë së Marrëdhënieve me Jashtë dhe Projekteve, z. G. Ç., ku citohet: “Mundësimin mbi fillimin e procedurave në përputhje me rregulloren e miratimit dhe zbatimit të projekteve filmike, artistike dhe të blerjes së të drejtave, të miratuara me vendimin nr. 10 datë 26.03.2018 të Këshillit Drejtues të RTSH-së, në mënyrë që projekti artistik me titull “Festival i 62 i Këngës në RTSH, një prodhim



Preventivi i dërguar për marrjen e ofertave është jo i detajuar dhe pa specifikimeve teknike, elementë të cilat janë të nevojshëm për të orientuar Operatorët Ekonomik për hartimin e një oferte reale ekonomike.

Nga auditimi i preventivit financiar të shpenzimeve për zhvillimin e Festivalit të 62 të Këngës, grupi i auditimit konstatoi se nuk ka transparencë se cila ishte rruga e ndjekur nga institucioni për marrjen e ofertave nga OE në treg. Grupit të auditimit nuk ju vu në dispozicion dokumentacion mbi korrespondencën me OE, por vetëm ofertat e dërguara nga disa prej tyre. Nuk është e qartë se si u informuan OE për të paraqitur oferta pranë RTSH-së.

Edhe pse procesi i marrjes së ofertave, analizës së tyre (për shkak të numrit të madh të elementëve përbërës të zërave përkatës), kërkon kohën e nevojshme, ashtu siç e kërkon këtë kohë dhe hartimi i preventivit të projektit artistik, konstatohet se i gjithë ky proces është bërë brenda së njëjtës datë, pra ofertat janë të protokolluara në të njëjtën datë me dërgimin e shkresës për miratimin e preventivit pranë Bordit të Administrimit, datë 06.12.2023.

Gjithashtu preventivi final nuk është i detajuar dhe nuk shpjegohet se si u arrit të përcaktohen vlerat përkatëse, mbi zëra e projektit për të cilët mungojnë të dhënat kryesore që përcaktojnë

vlerën e tyre. Sa më sipër në mospërputhje me Pikën 5, Neni 23 Informacioni dhe komunikimi, Ligji nr. 10 296 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Neni 18 Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së, Vendimi Nr. 98/2016 Për Miratimin E Statutit Të Radio Televizionit Shqiptar (RTSH)

Në lidhje me sa sipër, është dërguar observacion nga përfaqësues të Radio Televizionit Shqiptar, protokolluar në institucion me nr. 564/53, datë 12.06.2024 në të cilin në mënyre të përmbledhur thuhet:

Pretendimi i subjektit (i përmbledhur): Shkresa nr. 2299/11 nuk duhet parë si e veçuar nga shkresa me nr.2299/10 prot., datë 06.12.2023, përkundrazi.

Ndryshe nga sa konstaton Grupi i Auditimit, shkresa në fjalë (2299/11) detajon pikërisht preventivin.

Sa i përket shpjegimit se si u arrit të përcaktohen vlerat përkatëse, sikurse i është shpjeguar Grupit të Auditimit dhe në takimet me ta, vlerat janë të diktuar nga tregu audiovizual.

Në lidhje me shërbimet e kërkuara për realizimin e Festivalit, janë siguruar ofertat ekonomike përkatëse dhe vlera përkatëse e secilit zë është përcaktuar pikërisht prej tyre. Kurse vlerat e pjesëmarrësve/artistëve/bashkëpunëtorëve janë të diktuar nga vetë tregu artistik. Sig është shpjeguar edhe gjatë auditimit, Festivali është një sipërmarrje artistike, cilësia dhe suksesi i të cilit varet nga niveli i artistëve pjesëmarrës. Para së gjithash, është jo vetëm absurde dhe e pajustificueshme të merret për bazë një sistem tarifor i miratuar në vitin 2004 (Sistemi tarifor i RTSH-së) dhe të pretendosh të realizosh një Festival të suksesshëm në vitin 2023. Nga ana tjetër, vetë Rregullorja e Projekteve parashikon mundësinë që kur vlerat nuk janë parashikuar ose nuk përputhem me Sistemin tarifor, ato duhet të miratohen në Bordin e Administrimit dhe në Këshillin Drejtues....

Qëndrimi i grupit të auditimit: Pas analizimi të observacionit, të dërguar nga përfaqësues të institucionit, grupi i auditimit vlerëson se observacioni i dërguar nuk është në proporcion me qëllimin e gjetjes së kryer nga grupi i auditimit.

Për sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

Në po të njëjtën datë Bordit të Administrimit i drejtohet dhe Shkresa nr. 2299/11 nga Drejtuesi Artistik z. B. L. mbi platformën artistike të Festivalit të 62 të Këngës në RTSH. Ndër të tjera në shkresë përmendet: *“Në përfundim theksohet që kostot e prodhimit të këngës mund të rriten për shkak të një sërë faktorëve të ndryshëm që kanë të bëjnë me shtimin e numrit të këngëve dhe me artistët dhe performuesit: Një pjesë e mirë e buxhetit të festivalit mund të shkojë për të paguar artistët dhe performuesit, pasi janë zgjedhur të paraqiten artistë të mëdhenj ose të njohur ndërkombëtarisht dhe këta artistë të kërkojnë pagesa shumë të larta për performancën e tyre. Kostot e transportit, akomodimit dhe ushqimit për artistë dhe stafin e tyre mund të jenë relativisht jo të ulët. Sa i përket Teknologjisë dhe prodhimit Teknik, për të siguruar një përvojë të mirë audio dhe vizuale për pjesëmarrësit, festivali duhet të investojë në teknologjinë e nevojshme për të përmbushur standardet e performancës live. Kjo përfshin pajisje audio dhe video të avancuara, skenografi të ndryshueshme, etj.. kostoja e së cilave nuk është më ajo e viteve të kaluara”.*

Një ditë më pas, me datë 07.12.2023, Bordi i Administrimit me anë të Vendimit nr. 14 datë 07.12.2023, vendos si më poshtë:

“Të japë pëlqimin mbi preventivin për realizimin e projektit artistik “Festivali i 62 i Këngës në RTSH”, përkundrazi vlerës financiare prej 75,607,493 lekë”.

Bordi i Administrimit me përbërje:

- z. K. B.
- znj. V. B.
- z. D. Sh.
- znj. V. L.

Preventivi i ndryshuar jepet në Anekse (Tab. nr.2)

Në po të njëjtën datë, Drejtori i Përgjithshëm, me anë të shkresës nr. 1898/1 Prot., i drejtohet Këshillit Drejtues mbi miratimin e projektit artistik, rregullores së Festivalit të 62 të Këngës në RTSH dhe miratimin e biletave.

Me datë 13.12.2023, me anë të shkresës nr. 1421/1 Prot., me Vendim nr. 33, Këshilli Drejtues miraton projektin artistik me titull “Festivali i 62 i Këngës në RTSH” përkundrejt vlerës financiare prej 60,000,000 lekë, ku citon: “*Të miratojë projektin artistik me titull “Festivali i 62 i Këngës në RTSH” përkundrejt vlerës financiare prej 60,000,000 lekë, e cila përfaqëson vlerën përkatëse në buxhetin e vitit 2023, plus shtesën e inflacionit...*”

Këshilli Drejtues me përbërje:

- z. L. B.
- z. G. P.
- z. G. P.
- z. I. K.
- z. M. Sh.
- znj. M. S.
- znj. A. R.
- z. E. N.
- z. E. T.
- z. D. P.

Në parashikimin e buxhetit për vitin 2023 për projektin artistik Festivali i Këngës vlera është 47,000,000 lekë, ndërkohë që vlera e miratuar nga Këshilli Drejtues është 60,000,000 lekë. Si argumentim mbi rritjen e fondit prej 13,000,000 lekë, Këshilli Drejtues jep normën e inflacionit. Nga të dhënat zyrtare të Bankës së Shqipërisë norma e inflacionit, për vitin 2023 mesatarisht është 4.8%, që për vlerën e mësipërme të buxhetit prej 47,000,000 lekë, fondi për realizimin e projektit artistik Festivali i Këngës, duhej të ishte në vlerën 49,256,000 lekë (2,256,000 lekë shtesë inflacioni). Diferenca prej 10,744,000 lekë (13,000,000-2,256,000), e cila është rritje e paargumentuar e vlerës së projektit artistik, konsiderohet si fond i përdorur pa ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet. Sa më sipër në mospërputhje me Nenin 8 “Përgjegjshmëria Menaxheriale”, Ligji nr. 10296 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Preventivi përfundimtar jepet në Anekse në fund të materialit (Tab. nr.3)

Analizë krahasuese e zërave të preventivit me Festivalin 61

Nr.	Përshkrimi	Festivali 62	Festivali 61	Diferenca
I	Këngët pjesëmarrëse konkurruese	6,992,000	6,500,000	492,000
II	Anëtarët e Band-it Muzikor & të tjerë	2,988,500	2,762,000	226,500
III	Stafi artistik dhe administrativ	5,255,505	4,796,000	459,505
IV	Stafi realizues	589,411	780,000	(190,589)
V	Stafi teknik	300,000	2,599,000	(2,299,000)
VI	Skenografia	14,086,326	6,625,200	7,461,126
VII	Qiraja e Sallës të Pallatit të Kongreseve	3,240,000	3,375,000	(135,000)
VIII	Mjete me qira	12,316,366	9,280,000	3,036,366

IX	Komisioni përzgjedhës i këngëve	90,000	105,000	(15,000)
X	Juria e Festivalit	430,000	250,000	180,000
XI	Kupat e Festivalit	300,000	500,000	(200,000)
XII	Cmimet e Festivalit	950,000	1,450,000	(500,000)
XIII	Security	200,000	300,000	(100,000)
XIV	Arranzhuesi muzikor i këngës	1,800,000	960,000	840,000
XV	Honorare për të ftuarit këngëtarë në natën e tretë	600,000	640,000	(40,000)
XVI	Bileta udhëtimi avioni + trageti për të ftuarit	210,752	1,645,000	(463,743)
XVII	Akomodime për të ftuarit	970,505		
XVIII	Pagesat për të ftuarit	6,663,425	3,056,600	3,606,825
XIX	Pastrimi	300,000	0	300,000
XX	Dieta	425,000	0	425,000
XXII	Grimi	360,000	0	360,000
XXIII	Administrative	34,000	0	34,000
XXIV	Catering	50,000	0	50,000
XXV	Fondi Rezervë	848,210	1,700,000	(851,790)
	Totali	60,000,000	47,323,800	12,676,200

Në analizimin e zërave të preventivit të mësipërm, janë marrë në shqyrtim zërat e preventivit ku diferenca rezulton të jetë e lartë:

Përshkrimi	Festivali 62	Festivali 61	Diferenca
Skenografia	14,086,326	6,625,200	7,461,126
Mjete me qira	12,316,366	9,280,000	3,036,366
Pagesat për të ftuarit	6,663,425	3,056,600	3,606,825

Për zërat e preventivit të mësipërm janë marrë në shqyrtim urdhër shpenzimet dhe kontratat përkatëse

VI	Skenografia					14,086,326
1	Struktura shtresa skena (rental)	m2	320			1,859,663
2	Bazament për Ledëall (rental)	m2	250			684,623
3	Bazament për Ledfloor (rental)	m2	60			256,103
4	Planshet Skena (rental)	m2	378			4,016,609
5	MDF me shkelqim 280x122cm (290m2)	tabake	75			2,888,197
6	Këmbë Niveluese (rental)	copë	20			180,623
7	Plex për Ledfloor 10mm	m2	60			895,823
8	Pedanat e Muzikantëve	m2	70			442,223
9	Pedanat për dritat 60x60x20	copë	8			281,423
10	Led Strip RGB	ml	120			645,263
11	Perde e Zezë	m2	50			159,023
12	Tapet i Zi	m2	90			195,983
13	Tuba fi 48	ml	100			70,703
14	Kavallota	copë	200			256,007
15	Strukturë Metalike me Banner mat për Prapaskenën dhe Hollin	m2	20			60,623
16	Krijim dhe dhe Konceptim I Strukturës 3D studio dhe ndjekje punimesh	person	2			1,193,423

Në lidhje; me zërin Skenografia janë marrë tre oferta në treg nga 3 Operatorë, si më poshtë:

- L. me nr NIPT L.....P me ofertë teknike prej 15,238,400 lekë me TVSH
- D. P. AL me nr. NUIS K.....J me ofertë teknike 14,586,326 lekë me TVSH
- A. me ofertë teknike 15,511,080 lekë me TVSH

Grupi i auditimit konstatoi se nuk ka të dhëna të mjaftueshme nga preventivi që të jepen oferta nga O.E.si dhe për zërin 16 "Krijim dhe konceptim i strukturës 3D studio" duhet që të ishte krijuar dhe ti bashkëngjitej preventivit mbi dhënien e ofertave nga Operatorët Ekonomik.

Nga 3 ofertuesit është përzgjedhur oferta më e ulët, Operatori D. P. AL në vlerën prej 14,586,326 lekë me TVSH, ku me të cilin është lidhur dhe Kontrata me nr. 2800/3 Prot., datë 13.12.2023 midis palëve për vlerën 14,086,326 lekë me TVSH.

Grupit të auditimit nuk iu dha shpjegim mbi diferencën e krijuar midis vlerave, asaj të ofertuar dhe të kontraktuar, ku njësia dhe sasia mbetet e njëjtë. Diferenca midis dy vlerave është 500,000 lekë.

Sipas kushteve të kontratës si dhe sipas përshkrimit të zërave të preventivit, nuk kuptohet qartë nëse zërat e mësipërm do të merren me qira (rental siç janë specifikuar disa) apo do të blihen nga ana e Autoriteti Kontraktor. Pika 2, Neni 2 i Kontratës nr. 2800/3 Prot., datë 13.12.2023 citon: *“Të gjitha materialet e nevojshme për realizimin e Skenografisë do të sigurohen nga Shoqëria, të cilët duhet të jenë të cilësisë së mirë dhe të jenë të përshatshme për realizimin e Skenografisë. Në çdo rast, të gjitha materialet që përbëjnë skenografinë mbeten në pronësi të Shoqërisë dhe ajo është përgjegjëse për garantimin e tyre gjatë gjithë kohëzgjatjes”.*

Kjo mbetet e paqartë pasi në preventivin bashkëngjitur ka zëra të cilat janë elementë përbërës të shërbimit të dhënies me qira si:

Kavallota, copë 200 me vlerë 213,339 lekë pa TVSH

Tuba fi 48, ml100 me vlerë 58,919 lekë pa TVSH

Nga auditimi u konstatua se në preventivin e projektit për zhvillimin e festivali janë përfshirë mallra si zëra më vete, ndërkohë që janë elementë përbërës të shërbimit, duke krijuar mbivendosje në preventiv. Konkretisht zërat e mëposhtëm:

Kavallota, copë 200 me vlerë 213,339 lekë pa TVSH, tuba fi 48, ml100 me vlerë 58,919 lekë pa TVSH, janë materiale përbërës të cilët shërbejnë për realizimin e skenografisë, pra janë pjesë e shërbimit i cili është paguar njëherë nga RTSH dhe në këtë mënyrë, nuk mund të përfshihen si të ndarë në preventivin e projektit artistik si mall më vete. Për sa më sipër vlera prej 272,258 lekë pa TVSH konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e shtetit. Sa më sipër në mospërputhje me Pikën 2, Neni 2 i Kontratës nr. 2800/3 Prot., datë 13.12.2023

Në lidhje me sa sipër, është dërguar observacion nga përfaqësues të Radio Televizionit Shqiptar, protokolluar në institucion me nr. 564/53, datë 12.06.2024 në të cilin në mënyrë të përmbledhur thuhet:

Pretendimi i subjektit (i përmbledhur): Edhe ky gjykim i Grupit të Auditimit thjesht vijon të konfirmojë mungesën e njohurive të dy audituesve. Së pari, të gjithë zërat “nënkategoritë” e Skeografisë janë thjesht elemente skenografikë që në tërësinë e vet, krijojnë Skenografinë. Gjykimi i Grupit të Auditimit se nuk ka lë dhëna te mjaftueshme nga preventivi që të jepen oferta nga O.E është, sikurse edhe shprehet vetë Grupi i Auditimit: një gjykim. Por është i pabazë dhe i pambështetur në fakte apo parashikime ligjore e nënligjore. Të gjithë këto elementë skenografikë janë bërë për t'u kuptuar dhe realizuar nga subjektet dhe individë që njohin fushën e mediave audiovizive që lidhet me krijimin dhe realizimin e skenografive, në rastin konkret. Po ashtu, nënkategoria 16 “Krijim dhe konceptim i strukturës 3D studio ” nuk mund të ishte krijuar dhe t'i bashkëngjitej preventivit mbi dhënien e ofertave nga Operatorët Ekonomik, sic gjykon Grupi i Auditimit, pasi nga operatori ekonomik kërkohet pikërisht kjo gjë: krijimi i strukturës 3D. Sepse Struktura 3D, nga vetë fjala, është një strukturë e cila do duhet të realizohet nga OE me materialet përkatëse dhe të vendoset në Skenë, si pjesë e skenografisë.

Por, ndërkohë, OE për paraqitjen e ofertave u janë vënë në dispozicion dokumentet e nevojshme të Planimetrive për realizimin e Skenografisë, së bashku me zberthimet dhe përmasat përkatëse të çdo elementi.

Pikë së pari, edhe një herë saktësohet se Skenografia duhet pari si një e tërë dhe në asnjë rast nuk duhet dhe nuk ka se si elementët përbërës të saj të konsiderohen zi "zëra të veçantë".

Së dyti, në kontratën, së cilës i referohet Grupi i Auditimit nuk ka asnjë paqartësi. Referuar nenit 10, pika 7 të kontratës, sipas së cilës "Kushtet e kontratës interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e saj", del qartë se Skenografia me të gjithë elementët e saj është marrë në përdorim të përkohshëm, pra me qira, për këtë arsye, të gjitha materialet që përbëjnë skenografinë mbeten në pronësi të Shoqërisë dhe ajo është përgjegjëse për garantimin e tyre gjatë gjithë kohëzgjatjes. Në përfundim të ofrimit të shërbimit, subjekti ka bërë vetë heqjen e skenografisë nga Salla e pallatit të Kongreseve edhe ky fakt i është shpjeguar disa herë Grupit të Auditimit.

Sa i përket se:

ka zëra të cilat janë lë ekzagjerura për objektin e dhënies me qira si:

Kavallota, copë 200 me vlerë 256,007 lekë me TVSH

Tubafi 48, me vlerë 70,703 lekë me TVSH

Kjo lidhet — edhe një herë— me moskompetencën dhe mungesën e ekspertizës së Grupit të Auditimit, që nuk ka aftësinë profesionale për të vlerësuar se "kavallotat" dhe "tubat" janë elementë të skenografisë, të cilat realizohen dhe krijohen (pra priten dhe përpunohen) në mënyrë ekskluzive të skenografisë përkatëse për të cilën do të përdoren. Pas realizimit të qëllimit — pra, pas përfundimit të shfrytëzimit të Skenografisë këtë elementë bëhen të papërdorshëm, si edhe vetë Skenografia në tërësinë e saj. Siç i është shpjeguar edhe Grupit të Auditimit, arsyeja pse RTSH i ka marrë me qira shërbimet në fjalë, ka qenë pikërisht për shkak se nuk e ka parë të arsyeshme të fitojë pronësinë e një Skenografie e cila mund të përdoret vetëm 1 herë dhe vetëm në Sallën e Pallatit të Kongreseve.

Kjo është shprehur edhe në Relacionin e Drejtorit Artistik me nr. 2299/11 prot. datë 06.12.2023, i cili i është vënë në dispozicion edhe Grupit të Auditimit.

Në çdo rast, Grupi i Auditimit nuk ka specifikuar dhe as ka analizuar se përse këto vlera duken të ekzagjeruara dhe se mbi ç' baza apo metodologji ka arritur në këtë konkluzion.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Pas analizimi të observacionit, të dërguar nga përfaqësues të institucionit, grupi i auditimit rithekson dhe njëherë që skenografia përveç kavallotave dhe tubave fi ka dhe shumë elementë të tjerë përbërës të cilat pas përfundimit të skenografisë bëhen të papërdorshme. Ashtu siç e theksoni dhe vetë ju “Referuar nenit 10, pika 7 të kontratës, sipas së cilës "Kushtet e kontratës interpretohen njëri nëpërmjet tjetrit, duke i dhënë secilit kuptimin që del nga tërësia e saj", del qartë se Skenografia me të gjithë elementët e saj është marrë në përdorim të përkohshëm, pra me qira, për këtë arsye, të gjitha materialet që përbëjnë skenografinë mbeten në pronësi të Shoqërisë dhe ajo është përgjegjëse për garantimin e tyre gjatë gjithë kohëzgjatjes” do të thotë që çdo gjë mbetet në pronësi të shoqërisë dhe ose do merret si e një e tërë e gjithë skenografia ose qiraja do ndahet në të gjithë pjesët përbërëse të saj duke përfshirë dhe kavallotat me tubat fi.

Për sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

Një zë tjetër i rëndësishëm është Mjete me qira:

VIII	Mjete me qira				12,316,365.90
1	Audio set up salla	njësi+person		1,524,280.90	1,524,280.90
2	Ndriçim set up salla	njësi+person		3,991,995.00	3,991,995.00
4	Ledëall Display Floor 60 m2 + Led Display 120m2	njësi+person		2,101,050.00	2,101,050.00
8	Kran 15m + Kranist	njësi+person	1	672,000.00	672,000.00
9	Steady Cam + Operator	njësi+person	1	480,000.00	480,000.00
10	Gimbal + kamera	njësi+person	2+1	168,000.00	168,000.00
11	Lente 4.8	copë	2	288,000.00	288,000.00
12	ëireless video transmitter 700 meter	copë	2	228,000.00	228,000.00

13	Karel+Mirembajtje/Asistent kereli	njësi+person	1		287,040.00	287,040.00
14	Gimbal+Operator	njësi+person	1	6	48,000.00	288,000.00
15	Regji HD	njësi+person	1	8	286,000.00	2,288,000.00

Grupi i auditimit konstatoi që për të njëjtën sallë që është përdorur dhe vitet e kaluara për zhvillimin dhe realizimin e projektit artistik, për zërin “ndriçim set up salla”, shpenzimet janë në vlerën **3,991,995 lekë** me TVSH (rreth 3 herë më të lartë se vlera e këtij zëri në vitin paraardhës). Nga ana e autoriteti kontraktor janë situacionuar edhe zëra si:

Steady Cam+ Operator

Gimbal + Kamera

Gimbal + Operator, të cilët janë në vlerën **936,000 lekë** me tvsh, të cilët mund të mbuloreshin nga ana e punonjësve të institucionit, pasi ekzistojnë kapacitetet profesionale për këtë shërbim.

Efekti negativ financiar në vlerën totale prej **4,106,663 lekë** pa tvsh përbën përdorim të fondeve publike pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet nga RTSH. Sa më sipër në mospërputhje me Nenin 8 “Përgjegjshmëria Menaxheriale”, Ligji nr. 10 296 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Në lidhje me sa sipër, është dërguar observacion nga përfaqësues të Radio Televizionit Shqiptar, protokolluar në institucion me nr. 564/53, datë 12.06.2024 në të cilin në mënyrë të përmbledhur thuhet:

Pretendimi i subjektit (i përmbledhur): Edhe në këtë rast, giykimi i Grupit të Auditimit vjen si pasojë e mosqenit ekspertë të fushës dhe mungesës së njohurive të nevojshme. Nënvizohet se ndriçimi i një salle në funksion të një Festivali Kënge varet drejtpërdrejt nga kërkesat artistike dhe kërkesat regjisoriale, të cilat më pas, zbërthehen në kërkesa teknike. Është absolutisht e pabazuar dhe mbi të gjitha joprofesionale të bëhet një krahasim i vlerave financiare të 2 festivaleve, pa e shoqëruar me një analizë të plotë të sasisë dhe asaj që ka përfaqësuar ndriçimi i skenës të secilit festival. Sipas Grupit të Auditimit, i vetmi kriter apo arsye pse shpenzimi duhet të konsiderohet si i përdorur pa efektivitet, efikasitet dhe ekonomicitet është sepse qenka më i lartë se ai i viteve paraardhëse?! Po sa ka qenë sasia e "ndriçimit set-up salla" në Festivale paraardhëse dhe sa ka qenë në këtë Festival? A e ka bërë analizën Grupi i Auditimit? Duhet pasur parasysh se në Festival, këtë vit, 'ndriçimi set-up salla' ka qenë i shoqëruar edhe me operator (shërbim). Sipas kontratës nr. 2800/2 prot. datë 13.12.2023, të lidhur me subjektin, është cilësuar si Objekt kontrate:

1. Shoqëria i jep RTSH, në gëzim të përkohshëm dhe kundrejt shpërblimit të përcaktuar në nenin 4 të kontratës, sistemet dhe shërbimet e mëposhtme, të përbëra nga pajisjet elektronike të integruara së bashku me elementët përbërës ndihmës, përfshirë edhe shërbimin e operimit ("në vijim "Sistemet dhe shërbimi").

Sa i përket zërave si:

Steady Canz+ Operator

Gimbal + Kamera

Gimbal + Operator

Në dosjet që ka pasur në dispozicion Grupi i Auditimit ka qenë edhe Relacioni i Drejtorit Artistik me nr. 2299/11 prot. datë 06.12.2023. Sikurse edhe për të gjithë zërat e preventivit, është sqaruar se edhe këto kanë qenë kërkesa të platformës regjisoriale dhe artistike. Këto shërbime nuk mund të siguroheshin dot nga RTSH, pasi RTSH-së i mungojnë këto pajisje, për këtë arsye ato janë siguruar në formën e marrjes si shërbimit nga të tretët.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Pas analizimi të observacionit, të dërguar nga përfaqësues të institucionit, grupi i auditimit rithekson dhe njëherë që qëllimi i gjetjes është në mënyrë e

përdorimit të fondeve dhe jo në rëndësinë artistike të festivalit. Institucioni i RTSH mund të realizojë një festival i cili nga pikëpamja artistike mund të tejkalojë dhe festivalet ndërkombëtare të mirënjohura dhe pse jo, por a është kjo gjë në proporcion me menaxhimin e duhur financiar.

Për sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

Në zërin Ledwall Display Floor 60m² + Led Display 120m² duhet të përkohet me preventivin e Skenografisë ku kërkohet Bazament për Ledwall 250m² dhe Bazament për Ledfloor 60m². Në këtë rast është kërkuar bazament Ledwall 250m² për mbulimin me Led Display 120 m².

Sipas kontratës nr. 2800/2 Prot., datë 13.12.2023 të lidhur midis Radio Televizioni Shqiptar dhe "A."sh.p.k. me NIPT L.....M, Neni 2, Pika 1 citohet:

"Shoqëria i jep RTSH, në gëzim të përkohshëm dhe kundrejt shpërblimit të përcaktuar në Nenin 4 të kontratës, Sistemet dhe shërbimet e mëposhtme, të përbëra nga pajisjet elektronike të integruara së bashku me elementët përbërës ndihmës, përfshirë edhe shërbimin e Operimit (në vijim Sisteme dhe shërbimi):"

- Audio set up salla
- Ndrëçim set up salla
- Ledwall Display Floor (60m²) + Led Display (120m²)

Sipas kontratës nr. 2800/2 Prot., datë 13.12.2023 të lidhur midis Radio Televizioni Shqiptar dhe "A. sh.p.k. me NIPT L.....M, neni 2, pika 1, citohet që janë të integruara së bashku me elementët përbërës ndihmës, që do të thotë që zërat e përfshira në zërin Skenografia në preventivin në lidhje me bazamentet për Ledwall dhe Ledfloor, Plex për Ledfloor (të cilat janë të përfshira në Ledwall display floor dhe Led display), si dhe zëri Led Strip RGB (i përfshirë në zërin Ndrëçim set up salla), në vlerën respektive 1,836,549 lekë dhe 645,263 lekë sipas kontratës të lidhur midis RTSH-së dhe O.E. D. P. AL me nr. 2800/3 Prot., të jenë të preventuar në mënyrë fiktive. Efekti financiar në total në vlerën prej 2,481,812 lekë pa TVSH përbën dëm ekonomik mbi Buxhetin e Shtetit. Sa më sipër në mospërputhje me kushtet e Kontratës me nr. 2800/3 Prot.

Në lidhje me sa sipër, është dërguar observacion nga përfaqësues të Radio Televizionit Shqiptar, protokolluar në institucion me nr. 564/53, datë 12.06.2024 në të cilin në mënyrë të përmbledhur thuhet:

Pretendimi i subjektit (i përmbledhur):

Ledwall-i për Floor nuk është Ledwall për mur.

Skenografia dhe "Ndrëçimi set-up salla" janë dy gjëra krejt të kundërta dhe të veçanta. Skenografia është tërësia e elementëve artistikë, që përfshin ndriçime të ndryshme, grafika, instalime të mëdha, për të krijuar efekte vizuale në skenë dhe përreth saj. Kurse "ndriçimi set-up salla" përbëhet nga elementët e nevojshme të ndriçimit të cilat lidhen me kërkesat regjisoriale dhe përdoren sipas një platforme të mirë menduar regjisoriale dhe artistike. Ky përfshin jo vetëm ndriçimin skenik por edhe atë të pjesëve të ndryshme të sallës, sipas frekuencave të parapërcaktuara. Skenografia është struktura vizuale e skenës, kurse ndriçimi plotëson këtë strukturë përmes shumëllojshmërisë së dritave.

Zërat e preventivuar, pavarësisht ngjashmërisë në emërtesa, janë elementë të dy sistemeve të ndryshme ku çdonjëra prej tyre ka kryer funksionin e vet, pa iu mbivendosur në asnjë rast njëra-tjetrës, por përkundrazi, duke plotësuar njëra tjetrën. Për këtë arsye edhe vlerat (në sasi apo ml)

janë të ndryshme dhe nuk përkojnë. Përmes skenografisë krijohen dhe përcaktohen vendet — strukturat - se ku do të duhen të vendosen — montohen — dritat e ndriçimit.

Nga ana tjetër, termi "Sistem" që referohet në kontratën nr. 2800/2 prot., datë 13.12.2023 të lidhur midis Radio Televizioni Shqiptar dhe "A."sh.p.k. me NIPT L.....M, nuk ka të bëjë në kuptimin që i referohen Grupi i Auditimit 'Sistem' këtu do të thotë sistemi audio dhe sistemi i ndriçimit së bashku me Sistemet Komanduese përkatëse të tyre, të cilat përbëhen nga programe kompjuterike dhe sisteme digjitale të dedikuara Për kontrollin dhe komandimin e tyre, përgjatë zhvillimit të Festivalit.

Për rrjedhojë, vlera prej 2,481,812 lekë me tvsh, nuk mund të konsiderohet si dëm ekonomik mbi Buxhetin e Shtetit, pasi ajo nuk ka qenë fiktive, përkundrazi. Secili prej elementëve, qoftë skenografikë, qoftë ato të sistemeve audio dhe të ndriçimit ka kryer funksionin e vet përgjatë zhvillimit të Festivalit dhe kjo vërtetohet duke parë videogramet e Festivalit dhe jo përmes leximit të dokumenteve.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pasi analizoi pretendimin e subjektit nuk u arrit të sigurohen fakte dhe prova të reja.

Për sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

Në lidhje me zërin pagesa për të ftuarit:

XVIII	Pagesat për të ftuarit				6,663,425.00	6,663,425.00
1	Aktor	person	1		250,000.00	250,000.00
2	Aktor	person	1		610,000.00	610,000.00
3	Pianiste	person	1		360,525.00	360,525.00
4	Këngëtare	person	1		961,400.00	961,400.00
5	Këngëtar	person	1		4,168,000.00	4,168,000.00
6	Këngëtare	person	1		52,250.00	52,250.00
7	Aktor	person	1		104,500.00	104,500.00
8	Banda e këngëtarit	person	1		52,250.00	52,250.00
9	Banda e këngëtarit	person	1		52,250.00	52,250.00
10	Banda e këngëtarit	person	1		52,250.00	52,250.00

Nga analizimi i zërave të mësipërm, u kërkuar dokumentacioni mbështetës në lidhje me përzgjedhjen dhe korrespondencën me të ftuarit e më sipërm.

Grupi i auditimit konstatoi që për të ftuarit, pjesëmarrës në realizimin e projektit artistik Festivali i Këngës, nuk jepen detaje se si është bërë përzgjedhja e tyre. Gjithashtu nuk jepen detaje dhe si janë përcaktuar vlerat përkatëse për pagesën e të ftuarve të cilat variojnë nga 52,500 lekë deri në 4,168,000 lekë me TVSH për një natë. Duke qenë se buxheti i miratuar është tejkaluar me vlerën 6,663,425 lekë, si dhe duke vlerësuar se shpenzimet e kryera për të ftuarit kanë vlera që nuk shoqërohen me një argumentim konkret dhe shumë të larta, vlera prej 6,663,425 lekë konsiderohet përdorimi i fondeve publike pa ekonomikitet dhe efikasitet. Sa më sipër në mospërputhje me Nenin 8 “Përgjegjshmëria Menaxheriale”, Ligji nr. 10 296 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Në lidhje me sa sipër, është dërguar observacion nga përfaqësues të Radio Televizionit Shqipëtar, protokolluar në institucion me nr. 564/53, datë 12.06.2024 në të cilin në mënyrë të përmblodhur thuhet:

Pretendimi i subjektit (i përmblodhur): Në tërë korpusin ligjor që rregullon aktivitetin e RTSH-së nuk ka asnjë parashikim se mbi c'metodologji apo procedurë duhet të bëhet një studim i tillë. Në fakt, asnjë prej dy anëtarëve të Grupit të Auditimit nuk ka qenë ekspert i fushës së mediave audiovizive dhe as i fushës kulturore-artistike që të mund të vlerësojë natyrën dhe rëndësinë artistike të një Festivali, i cili, në fakt, i tejkalon kufijtë kombëtarë. Pa paragjykuar faktin se nuk

ka asnjë detyrim ligjor për të bërë një studim të tillë, një studim i tillë është edhe objektivisht i pamundur.

Me përjashtim të shërbimeve nga subjekte të treta tregtare, për të cilat është bërë një studim dhe janë siguruar ofertat përkatëse, për pjesën artistike çdo gjë përzgjidhet në bazë të kërkesës dhe ofertës që përfaqësojnë nivelin artistik të secilit pjesëmarrës. Është krejt absurde, për shembull, të përcaktosh se çfarë shpërblimi do të duhet për një të ftuar këngëtar dhe çfarë për një tjetër, që nuk është këngëtar, por aktor. Dhe e njëjta gjë ndodh edhe për çdo artist apo bashkëpunëtor tjetër.

Kihet parasysh se tarifa e përcaktuar, nuk nënkupton një pagesë apo shpërblim të thjeshtë, por lidhet drejtpërdrejt me shfrytëzimin e të drejtve të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to, me anë të të cilave vlerësohet puna e çdo artisti krijues.

Duke pasur parasysh sa më sipër, konstatohet edhe një herë se anëtarët e Grupit të Auditimit nuk janë ekspertët e duhur për të vlerësuar një aktivitet të tillë artistik dhe për rrjedhojë, përfundimet e tyre në akt-konstatim janë të padrejta, të paargumentuara dhe mbi të gjitha të pabazuar në asnjë ligj, akt nënligjor, apo akt rregullator.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pasi analizoi pretendimi e subjektit rithekson se grupi i auditimit nuk vlerëson natyrën dhe rëndësinë artistike të një festivali, por përdorimin, menaxhimin dhe transparencën e fondeve të institucionit.

Për sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

Në lidhje me zërin akomodime për të ftuarit:

XVII	Akomodime për të ftuarit					970,505.04
1	Akomodim në hotel	person	1	9	10,102.22	90,920.00
2	Akomodim në hotel	person	1	7	5,102.00	35,714.00
3	Akomodim në hotel	person	1	2	5,102.00	10,204.00
4	Akomodim në hotel	person	1	7	8,061.14	56,428.00
5	Akomodim në hotel	person	1	10	3,224.50	32,245.00
6	Akomodim në hotel	person	1	1	126,530.00	126,530.00
7	Akomodim në hotel	person	1	1	126,530.00	126,530.00
8	Akomodim në hotel	person	1	7	5,102.00	35,714.00
9	Akomodim në hotel	person	1	7	8,746.29	61,224.00
10	Akomodim në hotel	person	1	1	142,856.00	142,856.00
11	Akomodim në hotel	person	1	2	2,296.00	4,592.00
12	Akomodim në hotel	person	1	2	2,551.00	5,102.00
13	Akomodim në hotel	person	1	2	8,061.00	16,122.00
14	Akomodim në hotel	person	1	2	8,061.00	16,122.00
15	Akomodim në hotel	person	1	5	5,102.00	25,510.00
16	Akomodim në hotel	person	1	2	5,102.00	10,204.00
17	Akomodim në hotel	person	9	9	19,387.56	174,488.04

Nga analizimi i zërave të mësipërm, u kërkuar dokumentacioni mbështetës në lidhje me përzgjedhjen dhe klasifikimin e hoteleve për akomodimin e të ftuarve.

Për akomodimin e të ftuarve të Festivalit, Radio Televizioni Shqiptar ka lidhur marrëveshje me K. H. & T. me nr. 2299/15 Prot., datë 15.12.2023.

Marrëveshja do të zbatohet për bllokun e dhomave si më poshtë për data nga data 14.12.2023-23.12.2023.

Dhoma Standarde Teke 79 Euro/nata
Dhoma standarde dyshe 99 euro/nata
Executive Suite 104 euro/nata
Executive Suite dyshe 124 euro/nata
Presidential suite 700 euro/nata

Marrëveshja e lidhur, me nr. 2299/15 Prot., datë 15.12.2023, rezulton për 35 netë në total, ndërkohë që në preventivin e shpenzimeve janë 76 netë. Gjithashtu tarifat e vendosura në

preventivin e shpenzimeve ndryshojnë nga ato të marrëveshjes. Për akomodimin në hotel të netëve të mbeturave në preventivin e shpenzimeve (41 netë) nuk ekziston marrëveshje tjetër por vetëm fatura të sjella për llogari të Radio Televizionit Shqiptar.

Gjithashtu nga preventivi i shpenzimeve konstatohen dhe shuma të shpenzuara në vlera të larta për akomodimin në hotel. si 142,856 lekë/natë, 126,530 lekë/natë, vlera të cilat janë jo vetëm që janë jashtë vlerave të përcaktuara në marrëveshjen 2299/15 Prot., datë 15.12.2023 por edhe dukshëm jashtë logjikës mesatares të tregut. Këto veprime tregojnë për një menaxhim jo të mirë të fondeve publike.

Për akomodimin e të ftuarve të Festivalit, Radio Televizioni Shqiptar ka lidhur marrëveshje me K. H. & T. me nr. 2299/15 Prot., datë 15.12.2023. Nga auditimi u konstatua që për pjesëmarrës të caktuar kohëzgjatja e qëndrimit në hotel është më e madhe se 4 netë (netë që përkrijnë me zhvillimin e festivalit). Personat e përfshirë në preventivin e pagesave për akomodimin në hotel, janë punonjës të cilat kanë punuar për skenografinë e festivalit, të punësuar pranë kompanisë D. P. AL (kompania që ka realizuar Skenografinë).

Në kushtet e kontratës të lidhur midis RTSH dhe OE D. P. AL, nuk është përfshirë zëri për akomodimin e punonjësve të kompanisë në hotel dhe për këtë arsye shpenzimet për këtë zë, nuk duhej të ishin kryer nga fondet e RTSH. Vlera e shpenzuar për akomodimin e punonjësve prej **248,044 lekë pa TVSH**, përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit. Sa më sipër në mospërputhje me kushtet e Kontratës me nr. 2800/3 Prot..

Nga auditimi i marrëveshjes së lidhur për akomodimin e të ftuarve të Festivalit, midis Radio Televizionit Shqiptar dhe K. H. & T, me nr. 2299/15 Prot., datë 15.12.2023, rezulton se kjo marrëveshje është lidhur për 35 netë në total, ndërkohë që në preventivin e shpenzimeve janë 76 netë. Gjithashtu tarifat e vendosura në preventivin e shpenzimeve ndryshojnë nga ato të marrëveshjes. Për akomodimin në hotel të netëve të mbeturave në preventivin e shpenzimeve (41 netë), nuk ekziston marrëveshje tjetër por vetëm fatura të sjella për llogari të Radio Televizionit Shqiptar.

Gjithashtu nga preventivi i shpenzimeve konstatohen shpenzime në vlera të larta për akomodimin në hotel, të tilla si 142,856 lekë/natë, 126,530 lekë/natë, vlera të cilat jo vetëm që janë jashtë vlerave të përcaktuara në marrëveshjen 2299/15 Prot., datë 15.12.2023 por edhe dukshëm jashtë logjikës mesatares të tregut. Këto veprime tregojnë për një menaxhim jo të mirë të fondeve publike. Sa më sipër në mospërputhje me Ligjin nr. 10 296 “Për Menaxhimin Financiar Dhe Kontrollin”

Në lidhje me sa sipër, është dërguar observacion nga përfaqësues të Radio Televizionit Shqiptar, protokolluar në institucion me nr. 564/53, datë 12.06.2024 në të cilin në mënyrë të përmbledhur thuhet:

Pretendimi i subjektit (i përmbledhur): Konstatimet e mësipërme nuk qëndrojnë, pasi siç edhe është shpjeguar gjatë intervistave me Grupin e Auditimit, të ftuarit përcaktohen nga linja artistike që ndjek Festivali. Prania e tyre është siguruar përmes negociatave të vazhdueshme dhe pjesëmarrja e secilit prej tyre dokumentohet me anë të kontratës përkatëse të administruar edhe nga Grupi i Auditimit.

Por, për të kuptuar se si fillojnë, zhvillohen dhe mbyllën negociatat me të ftuarit në të tilla evenimente, nevojitet një ekspert i fushës që rregullon të drejtat e autorit dhe të drejtat e tjera të lidhura me to, si dhe një ekspert i fushës kulturore-artistike dhe i mediave audiovizive dhe, për fat të keq, asnjë prej 2 audituesve nuk ishte i tillë. Ashtu siç grupi i audituesve kërkon persona eksperte

nëpër procedura, duhet që ne radhe të parë, ata vetë të jenë eksperte të fushës për të bërë këto konstatime dhe nga vetë deklaratat e tyre, grupi i auditimit auditonte një Radio Televizion për herë të parë, çka përforcon akoma edhe me shumë faktin se ekspertiza e tyre është e pamjaftueshme për të identifikuar realisht funksionimin e RTSH-se.

Gjykimi i Grupit të Auditimit se vlerat janë të ekzagjeruara, nuk shoqërohen me asnjë argument se pse dhe, për rrjedhojë, mbeten thjesht gjykim i tyre personal dhe pa vlerë ligjore.

Po kështu edhe pretendimi se janë shpenzuar më shumë për akomodime.

Duhet sqaruar se Festivali nuk duhet parë si një event zgjat vetëm 4 net, sa ç'janë netët e Spektaklit, por ai fillon kohë më parë, që nga momenti i fillimit të konceptimit të idesë, por edhe i krijimit të ideve të skeografisë etj., deri në fillimin e organizimit të vërtetë, për përgatitjen e Sallës dhe krejt krijimin dhe realizimin e Skenografisë. Për këtë arsye disa nga prej bashkëpunëtorëve kanë qenë të nevojshëm për të qenë të pranishëm për më shumë se 4 netët e Festivalit.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pasi analizoi pretendimi e subjektit rithekson se grupi i auditimit nuk vlerëson natyrën dhe rëndësinë artistike të një festivali, por përdorimin, menaxhimin dhe transparencën e fondeve të institucionit.

Për sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

Të ardhurat e gjeneruara nga zhvillimi i festivalit

Me datë 15.12.2023 është nënshkruar kontrata e shërbimit me nr.2800/4 prot ,ndërmjet RTSH e përfaqësuar nga drejtori i përgjithshëm A. P. dhe shoqërisë “V. t” sh.p.k e përfaqësuar nga administratori A. K. Objekti i kontratës është bashkëpunimi midis palëve, ku ofruesi i shërbimit merr përsipër të shesë bileta për eventin e titulluar “Festivali i 62 i këngës në RTSH, organizuar nga klienti në datat 19-22 dhjetor 2023 në sallën e Pallatit të Kongreseve. Sipas kontratës se sipërcituar eventin parashikon të ketë një kapacitet prej rreth 1800 vende të cilat do të shiten sipas çmimeve vijuese:

- a)Nata e parë ,datë 19.12.2023 bileta me çmimin 1,000 lekë/ 10 euro
- b)Nata e dytë ,datë 20.12.20 bileta me çmimin 1,000 lekë/10 euro
- c)Nata e tretë, date 21.12.2023 bileta me çmimin 1500 lekë/15 euro
- d)Nata e katërt, date 22.12.2023 bileta me çmim 2,000 lekë/20 euro

Sipas faturës tatimore nr. 2/2024 date 11.01.2024 ,klienti “V. ti” ka faturuar shumën në vlerën 2,880,007.49 leke me TVSH për shitjen e biletave për eventin “Festivali i 62 i këngës në RTSJH”.

Artikujt e faturës:

- Shitje bileta nata 1 “Fest 62” copë 268 vlera 223,332.44 lekë pa TVSH.
- Shitje bileta nata 2 “Fest 62” copë 484 vlera 403,331.72 lekë pa TVSH.
- Shitje bileta nata 3 “Fest 62” copë 544 vlera 680,000 lekë pa TVSH.
- Shitje bileta nata 4 “Fest 62” copë 656 vlera 1,093,342.08 lekë pa TVSH.

Pika 4.4.1 e kontratës parashikon se “Çmimi i shërbimit do të llogaritet bazuar në vlerën e biletave të shitura nga ofruesi i shërbimit. Klienti bie dakord të paguaje në formën e një komisioni prej 6.5 % të ardhurave nga shitja e biletave”.

Sipas të dhënave nga sektori i financës janë kredituar në llogarinë bankare të RTSH-së në total 2,692,807 lekë, për shitjen e biletave nga ofruesi i shërbimit ,shoqëria “V. T” sh.p.k.

Me shkresën 2800/26 date 26.12.2023 u mbajt procesverbali “mbi shpërndarjen e ftesave dhe shitjen e biletave të festivalit të 62 të këngës në RTSH”. Procesverbali u mbajt nga E. T. ,koordinatore për sallën, P. T. - Koordinatore për protokollin, Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së A. P. dhe Administratori i “V. T.” A. K.

Sipas rakordimeve për natën e parë

Vende në salle	Vende të hequra nga skenografia dhe regjia	Ftesa struktura drejtuese dhe sponsor	Total vende të shitura Vivere ticketing	Vende të pashitura
2043	504	489	268	782

Për natën e dytë

Vende në salle	Vende të hequra nga skenografia dhe regjia	Ftesa struktura drejtuese dhe sponsor	Total vende të shitura Vivere ticketing	Vende të pashitura
2043	504	507	484	548

Për natën e tretë

Vende në salle	Vende të hequra nga skenografia dhe regjia	Ftesa struktura drejtuese dhe sponsor	Total vende të shitura “Vivere ticketing” sh.p.k	Vende të pashitura
2043	504	591	544	404

Për natën e katërt

Vende në salle	Vende të hequra nga skenografia dhe regjia	Ftesa struktura drejtuese dhe sponsor	Total vende të shitura Vivere ticketing	Vende të pashitura
2043	504	812	656	71

Në baze të dhënave nga dokumentacioni i vende në dispozicion numri total i vendeve për shitje ka qenë 3757 vende ,numri total i ftesave 2399 ftesa, numri total i vendeve të pa shitura 1805 vende, nga kjo duke zbritur numrin e ftesave, totali i biletave të shitura ka qene në masën 51.9 % e totalit të biletave për shitje, për të katër netët e festivalit.

Përsa i përket numrit total të ftesave të dërguara (2399 ftesa), në dosjen e paraqitur grupit të auditimit ,nuk ka dokumentacion të administruar për shpërndarjen e tyre.

Sipas kontratës 2800/4 datë 15.12.2023 pika 2.2.4 “Ofruesi i shërbimit ka lirinë të zgjedhë mënyrën e shitjes së biletave dhe ndarjen e tyre mes biletave që ofrohen përmes platformës online dhe shitjes fizike për të optimizuar shërbimin e shitjes ndaj klientëve duke përfshirë por pa u limituar në: aplikacioni Vivere Ticketing; faqja e internetit Vivere ticketing; pranë çdo pike të autorizuar nga ofruesi i shërbimit”.

Në kontratën e nënshkruar mes RTSH-së dhe shoqërisë “V. t”,nuk është përcaktuar qartë numri i biletave për shitje, por vetëm citohet që “eventi parashikon të ketë një kapacitet prej 1800 vendesh”.

Grupit të auditimi nuk i janë vënë në dispozicion dhe dokumentacioni në lidhje me ftesat drejtuar strukturave drejtuese dhe sponsoreve, mbi mënyrën e dërgimit dhe njoftimit të tyre.

Të ardhura të tjera janë realizuar nga votimet e kryera nga qytetarët brenda dhe jashtë Shqipërisë përkundrejt një tarife të caktuar. Votimet kryhen me anë të SMS dhe ekzistojnë marrëveshje të lidhura midis Radio Televizionit Shqiptar dhe kompanive telefonike si: V. A sh.a., O. A. sh.a., I.P.K.O. T. sh.p.k. dhe V. K. T. sh.a.

Grupi i auditimit konstatoi që në Rregulloren e Projekteve Artistike dhe Filmike dhe në Rregulloren e Festivalit të Këngës, nuk përcaktohet qartë gjurma e auditimit mbi dokumentimin e proceseve që nga marrja e ofertave në treg, përcaktimin e fondit limit, përzgjedhjen e operatorëve dhe deri në lidhjen e kontratave. Gjithashtu në rregullore nuk përcaktohet roli dhe detyrat e grupit të punës të ngritur për menaxhimin dhe ndjekjen e zhvillimit të festivalit të këngës. Sa më sipër në

mospërputhje me Pikën 5, Neni 23 Informacioni dhe komunikimi, Ligji nr. 10 296 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”.

Në lidhje me sa sipër, është dërguar observacion nga përfaqësues të Radio Televizionit Shqipëtar, protokolluar në institucion me nr. 564/53, datë 12.06.2024 në të cilin në mënyrë të përmbledhur thuhet:

Pretendimi i subjektit (i përmbledhur): Ndryshe nga sa pretendohet, Grupit të Auditimit iu vendos në dispozicion i gjithë dokumentacioni i nevojshëm për të arritur në një konkluzion të bazuar. Shitja e biletave është bërë sipas kontratës dhe në përfundim të saj, palët kanë nënshkruar edhe proces-verbalin përkatës.

Numri total i shitjeve të biletave qëndron tek kapaciteti total i Sallës, por numri i shitjeve nuk mund të përcaktohet shprehimisht në kontratë, pasi askush nuk mund të parapërcaktojë numrin e shitjeve të biletave të një eventit. Ajo që është e rëndësishme është se në përfundim, numri i biletave të shitura është pasqyruar në proces verbalin e mbajtur nga të dy palët dhe saktësohet në vlerën monetare që ka përfutur RTSH nga kjo shitje.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit pasi analizoi pretendimin e subjektit rithekson se grupit të auditimit nuk i është vënë në dispozicion dokumentacioni mbi ftesat drejtuar strukturave drejtuese dhe sponsove. Ashtu siç nuk janë sjellë dhe gjatë fazave të observimit.

Për sa më sipër observacioni nuk merret në konsideratë.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga Auditimi: Me urdhrin nr. 96, datë 13.07.2023 të Drejtorit të Përgjithshëm të RTSH, është ngritur grupi i punës për Festivalin e 62 të Këngës në RTSH, në përbërje të të cilit nuk ka asnjë person specialist të fushës për të garantuar hartimin e kërkesave teknike për zhvillimin e festivalit. Urdhri nuk përcakton detyra konkrete për grupin e punës, pra në urdhër nuk përcaktohet se nga kush do të kryhet hartimi i kërkesave teknike të skenografisë për zhvillimin e festivalit.

Nga auditimit i Rregullores së Festivalit të 62 të Këngës për vitin 2023, si dhe Platformës Regjisoriale dhe Artistike hartuar nga regjisori i festivalit z. P. K. dhe drejtori artistik i festivalit, z. B. L., hartimi i kërkesave teknike, pjesë e platformës regjisoriale, nuk janë në kompetencat e drejtorit artistik dhe të regjisorit të festivalit.

Nga intervistimi me anëtarët e grupit të punës, shqyrtimi dhe vlerësimi i hartimit të kërkesave teknike, u konstatua se përgatitja e skenografisë nuk është kryer nga grupi i punës. Anëtarët e grupit të punës, për çështjet teknike të skenografisë, në kushtet kur nuk janë të hartuar nga ana e tyre, nuk duhet të kishin pranuar dhe miratuar një dokument i cili është hartuar nga persona apo subjekte të cilët nuk kanë marrëdhënie kontraktuale me RTSH.

Gjithashtu Rregullorja e Festivalit të 62 të Këngës nuk është hartuar e plotë, pasi ka mangësi në përcaktimin e detyrave konkrete për punonjësit, konkretisht nuk është parashikuar se cilët janë personat përgjegjës të cilët kanë për detyrë hartimin e kërkesave teknike, pjesë e platformës regjisoriale. Sa më sipër në mospërputhje me Nenin 4 dhe 8 të Rregullores së Festivalit të 62 të Këngës në RTSH.

(Më hollësisht trajtuar në faqen 16, të Projekt Raportit të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Nga Titullari i institucionit të merren masat në të ardhmen që, në zhvillimet e projekteve artistike, të përfshijnë në grupet e punës ekspertë të hartimit të kërkesave teknike dhe të skenografisë.

1.2 Rekomandimi: Titullari i institucionit, Këshilli Drejtues, të marrë masat për përfshirjen në rregulloren për organizimin e festivaleve të këngës të detyrave dhe rolin e anëtarëve të grupit artistik, me qëllim që qartësimin e detyrave që do të kryej secili anëtar i grupit të punës.

Në vijimësi

2. Gjetje nga Auditimi: Nga auditimi i preventivit financiar të shpenzimeve për zhvillimin e Festivalit të 62 të Këngës, grupi i auditimit konstatoi se nuk ka transparencë se cila ishte rruga e ndjekur nga institucioni për marrjen e ofertave nga OE në treg. Grupit të auditimit nuk ju vu në dispozicion dokumentacion mbi korrespondencën me OE, por vetëm ofertat e dërguara nga disa prej tyre. Nuk është e qartë se si u informuan OE për të paraqitur oferta pranë RTSH-së.

Edhe pse procesi i marrjes së ofertave, analizës së tyre (për shkak të numrit të madh të elementëve përbërës të zërave përkatës), kërkon kohën e nevojshme, ashtu siç e kërkon këtë kohë dhe hartimi i preventivit të projektit artistik, konstatohet se i gjithë ky proces është bërë brenda së njëjtës datë, pra ofertat janë të protokolluara në të njëjtën datë me dërgimin e shkresës për miratimin e preventivit pranë Bordit të Administrimit, datë 06.12.2023.

Gjithashtu preventivi final nuk është i detajuar dhe nuk shpjegohet se si u arrit të përcaktohen vlerat përkatëse, mbi zëra e projektit për të cilët mungojnë të dhënat kryesore që përcaktojnë vlerën e tyre. Sa më sipër në mospërputhje me Pikën 5, Neni 23 Informacioni dhe komunikimi, Ligji nr. 10 296 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, Neni 18 Drejtori i Përgjithshëm i RTSH-së, Vendimi Nr. 98/2016 Për Miratimin E Statutit Të Radio Televizionit Shqiptar (RTSH) (Më hollësisht trajtuar në faqen 18, të Projekt Raportit të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Nga titullari i institucionit, personat përgjegjës për zhvillimin e projekteve artistike, në lidhje me përcaktimin e fondeve të projekteve artistike, marrjen e ofertave në treg, të kryet një procedurë transparente dhe gjithëpërfshirëse duke adresuar saktë objektin e veprimtarisë së Operatorëve ekonomikë.

Në vijimësi

3. Gjetje nga Auditimi: Në Rregulloren e Projekteve Artistike dhe Filmike dhe në Rregulloren e Festivalit të Këngës, nuk përcaktohet qartë gjurma e auditimit mbi dokumentimin e proceseve që nga marrja e ofertave në treg, përcaktimin e fondit limit, përzgjedhjen e operatorëve dhe deri në lidhjen e kontratave. Gjithashtu në rregullore nuk përcaktohet roli dhe detyrat e grupit të punës të ngritur për menaxhimin dhe ndjekjen e zhvillimit të festivalit të këngës. Sa më sipër në mospërputhje me Pikën 5, Neni 23 Informacioni dhe komunikimi, Ligji nr. 10 296 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”

(Më hollësisht trajtuar në faqen 28, të Projekt Raportit të Auditimit)

3.1 Rekomandimi: Këshilli Drejtues, Titullari i Institucionit, Bordi i Administrimit, gjatë hartimit të Rregullores së Festivalit të Këngës, të përcaktojë rrugën që duhet të ndiqet mbi marrjen e ofertave në treg, përllogaritjen e fondit për zhvillimin e projekteve artistike, me qëllim sigurimin e transparencës në përcaktimin e kostove dhe realizimin e kostove të detajuara për projektet artistike.

Menjëherë

C. MASA SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë” nenet 98-102, Titullari i institucionit në bashkëpunim me nëpunësin zbatues, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet

në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **3,002,114 lekë pa TVSH** sipas gjetjeve dhe rekomandimeve të trajtuara më poshtë:

1. Gjetje nga Auditimi: Për akomodimin e të ftuarve të Festivalit, Radio Televizioni Shqiptar ka lidhur marrëveshje me “K. H. & T” me nr. 2299/15 Prot., datë 15.12.2023. Nga auditimi u konstatua që për pjesëmarrës të caktuar kohëzgjatja e qëndrimit në hotel është më e madhe se 4 netë (*netë që përkojnë me zhvillimin e festivalit*). Personat e përfshirë në preventivin e pagesave për akomodimin në hotel, janë punonjës të cilat kanë punuar për skenografinë e festivalit, të punësuar pranë kompanisë “D. P. AL” (kompania që ka realizuar Skenografinë).

Në kushtet e kontratës të lidhur midis RTSH dhe OE “D. P. AL”, nuk është përfshirë zëri për akomodimin e punonjësve të kompanisë në hotel dhe për këtë arsye shpenzimet për këtë zë, nuk duhej të ishin kryer nga fondet e RTSH. Vlera e shpenzuar për akomodimin e punonjësve prej 248,044 lekë pa TVSH, përbën dëm ekonomik për Buxhetin e Shtetit. Sa më sipër në mospërputhje me kushtet e kontratës nr. 2800/3 Prot. Datë 13.12.2023.

(Më hollësisht trajtuar në faqen 26, të Projekt Raportit të Auditimit)

1.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit, të marrë të gjitha masat e duhura ligjore, për kthimin e vlerës prej **248,044 lekë pa TVSH** nga OE “D. P. AL”, si vlerë e përfutur jashtë marrëdhënieve kontraktuale, si dhe të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për këtë parregullsi.

Menjëherë

2. Gjetje nga Auditimi: Në preventivin e projektit për zhvillimin e festivali janë përfshirë mallra si zëra më vete, ndërkohë që janë elementë përbërës të shërbimit, duke krijuar mbivendosje në preventiv. Konkretisht zërat e mëposhtëm:

Kavallota, copë 200 me vlerë 213,339 lekë pa TVSH, tuba fi 48, ml 100 me vlerë 58,919 lekë pa TVSH, janë materiale përbërës të cilët shërbejnë për realizimin e skenografisë, pra janë pjesë e shërbimit i cili është paguar njëherë nga RTSH dhe në këtë mënyrë, nuk mund të përfshihen si të ndarë në preventivin e projektit artistik si mall më vete. Për sa më sipër vlera prej 272,258 lekë pa TVSH konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e shtetit. Sa më sipër në mospërputhje me kushtet e kontratës nr. 2800/3 Prot. Datë 13.12.2023.

(Më hollësisht trajtuar në faqen 22, të Projekt Raportit të Auditimit)

2.1 Rekomandimi: Titullari i institucionit, të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për kthimin e vlerës prej **272,258 lekë pa TVSH** nga OE “D. P. AL”, si dhe të analizojë dhe nxjerrë përgjegjësitë për këtë parregullsi.

Menjëherë

